Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 01/430 Data: 17.11.2016
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/480
Datë: 17.11.2016

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 9, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa për lejim për aplikim për validim dhe akreditim të institucionit për ato kualifikime për të cilat ekzistojnë standardet e profesionit të miratuara në nivel kombëtar.

2. Institutit Profesional ATC i lejohet që të aplikojë për validim dhe akreditim të institucionit për këto kualifikime:
   - Furrtar;
   - Mishtar;
   - Instalues Elektrik;
   - Instalues i ngrohjes qendrore;
   - Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit';
   - Agjent Turistik dhe i informimit për udhëtime;
   - Automekanik;
   - Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla;
   - Gjuhë gjermane;
   - Gjuhë angleze;
   - Gjuhë italiane;
   - Parukier/e.

3. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i obliguar që të njoftojë institucionin për përgatitjen e aplikimit dhe të vazhdojë procesin sipas legjislacionit në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet të gjitha palëve të interesit.



Nën- kryetari i KD së AKK
Anton Gojani